



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 gusht 2011
Nr. ref.: RK135/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 87/10

Parashtruesi

Shpresa Loxha-Pllana

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Komunale të Pejës,
C.nr. 644/06, të 1 korrikut 2008.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Shpresa Loxha-Pllana, me vendbanim në Mitrovicë, e përfaqësuar nga Sami Sharaxhiu, jurist nga Peja.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar nga parashtruesja e kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë i 1 Korrikut 2008, i cili i është dhënë parashtrueses së kërkesës po të njëjtën ditë.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa e Parashtrueses ka të bëjë me mos-zbatimin e ligjit, pa cekur se cilit ligj, dhe/ose cila gjykatë, si p.sh Gjykata Komunale në Pejë dhe/ose Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Kushtetuta”), neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: “Ligji”) dhe Rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Rregullorja e Punës”).

Procedura në Gjykatë

5. Më 20 shtator 2010, Parashtruesja dorëzoi Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: “Gjykata”).
6. Më 9 nëntor 2010, Kërkesa iu përcoll Gjykatës Komunale në Pejë.
7. Më 14 dhjetor 2010, Kryetari, me Urdhërin Nr.GJR. 87/10, emëroi Gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhërin Nr.KSH. 87/10, emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët Altay Suroy (Kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalovič.
8. Më 16 maj 2011, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalovič shqyrtuan raportin e Gjyqtarit Raportues Robert Carolan dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 13 korrik 1929, Gjykata e shkallës së parë në Pejë (Nr. 169) lëshoi një vendim që njohu pronësinë juridike të tokës në Pejë e cila i takonte gjyshit të parashtrueses së kërkesës në bazë të Tapisë (regjistrit të tokave).
10. Kjo pronë ishte shtetëzuar nga qeveria në vitet 1930.
11. Më 18 mars 1936, Gjykata Ekonomike e Dubrovnikut (Gjykimi POSL. NR.U25/35/8) I njohu të drejtën e pronësisë për tokën e shtetëzuar të gjyshit të parashtrueses së kërkesës dhe urdhëroi autoritetet që të kujdesen për kthimin e tokave të konfiskuara pronarit të

ligjshëm, pra gjyshit të parashtrueses së kërkesës. Megjithatë, ky vendim nuk u zbatua dhe nuk u ekzekutua nga autoritetet.

12. Më 3 mars 1946, gjyshit të parashtrueses së kërkesës iu shtetëzuan 48,65,36 Ha tokë në Pejë me Vendimin e Gjykatës Agrare të Qarkut për Kosovë në Prishtinë (Nr. 591).
13. Më 11 prill 1946, Gjykata Agrare e Qarkut për Kosovë në Prishtinë (Nr. 1182) i ktheu një pjesë të titullit juridik tokës së gjyshit të parashtrueses së kërkesës.
14. Trashëgimtarët e gjyshit të ndjerë të parashtrueses së kërkesës më 1985 i drejtuan kërkesë Këshillit Ekzekutiv të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK) Sekretariatit për financa dhe ekonomi – kundër vendimit të Gjykatës Agrare të Qarkut. Ata kërkuan rinisjen e procedurave pasi që kishin vërejtur fakte të reja.
15. Më 3 prill 1985, Drejtorati Krahinor për Prona dhe Çështje Juridike në Prishtinë refuzoi kërkesën për rinisjen e procedurave të përmbyllura me vendimin e Gjykatës Agrare të Qarkut me arsyetimin se u kishte kaluar koha (nr. 03-466-993/84). Ky vendim u apelua në Gjykatën Supreme të Kosovës.
16. Më 14 nëntor 1985, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazë, kërkesën për rinisjen e procedurave meqenëse u kishte kaluar koha (A-nr. 745/85).
17. Më 19 shkurt 1999, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesën tek Komisioni për rikthimin e tokave pronarëve të mëhershëm pranë Kuvendit Komunal në Pejë për rikthimin e tokës së marrë nga paraardhësit e saj. Asnjë përgjigje apo vendim nuk është i pranishëm lidhur me këtë në dosjen e rastit.
18. Më 8 dhjetor 2005, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesën për rikthimin e pasurisë së shtetëzuar, e cila momentalisht është në shfrytëzim të Institutit Bioteknik të Pejës, sipas Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: “AKM”).
19. Më 4 tetor 2006, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë tek Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme duke kërkuar anulimin e vendimit të shtetëzimit të tokës. Më 31 Janar 2007, Dhoma e Posaçme barti rastin tek Gjykata Komunale e Pejës që të vendosë për këtë çështje dhe njoftoi se poqëse parashtruesja e kërkesës do të ankohej ndaj vendimit të Gjykatës Komunale, kjo do të duhej të bëhej para Dhomës së Posaçme.
20. Më 30 gusht 2006, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale të Pejës për anulimin e vendimit të shtetëzimit të tokës. Më 1 korrik 2008, gjatë dëgjimit kryesor ishte vendosur që të ndërpriten procedurat lidhur me propozimin e përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës, pasi që ishte e nevojshme që së pari të vendosej në procedurat preliminare, nëse do të transformohej AKM-ja në një agjenci të re, siç thuhet në letrën drejtuar Parashtrueses, të datës 4 korrik 2008, ose do të arrihet zgjidhja pas themelimit të shtetit të Kosovës. Përfaqësuesi i të paditurit nuk kishte asgjë kundër propozimit të ndërprerjes, pasi që procedura nuk do të mund të ri-nisej sipas kërkesës së njëjës palë kontestuese.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Komunale e Pejës dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk e kanë zbatuar ligjin.

Vlerësimi paraprak për pranueshmërinë e kërkesës

22. Sa i përket kërkesës së parashtrueses lidhur me mos-zbatimin e ligjit, pa e cekur se cilit ligj, dhe/ose cilës gjykatë, si p.sh Gjykata Komunale e Pejës dhe/ose Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, është e nevojshme që së pari të analizohet nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kërkesat për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, si dhe të cekura në Ligjin dhe Rregulloren e Punës.

23. Si një nga kërkesat, parashtruesja duhet të vërtetojë se ka dorëzuar Kërkesën brenda afatit 4 muaj, siç parashihet në nenin 49 të Ligjit. Megjithatë, siç duket edhe nga dërgesat e parashtrueses së kërkesës, vendimi i fundit gjyqësor për rastin e saj ishte Vendimi i Gjykatës Komunale të Pejës C.nr. 644/06, i datës 1 korrik 2008, i dhënë asaj më 1 korrik 2008, përderisa ajo ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese tek më 20 shtator 2010, çka është më shumë se 4 muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit (shih nenin 56 të Ligjit). Për të qenë e pranueshme kërkesa do të duhej paraqitur para 15 majit 2009 sipas dispozitave të kombinuara ligjore të nenit 49 dhe 56 të Ligjit.

24. Nga kjo del se kërkesa nuk është në përputhshmëri me nenin 49 të Ligjit.

25. Sa i përket çështjes së kthimit të pronave, Gjykata Kushtetuese i referohet rastit të mëhershëm të 15 tetorit 2010 - KI 14/09 Trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës kundër Vendimit Nr.PKL.Nr.21/07 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 17 dhjetor 2008.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata kushtetuese, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullit 56(2) të Rregullores së Punës, njëzëri më 16 maj 2011

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u njoftohet Palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtueshmëri me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani